



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr. 471, datë 31.07.2024**

**PËR  
TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT  
{...} NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË  
PËRGJITHSHËM DURRËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” i ndryshuar, në vendimin nr. 428 datë 31.07.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsideratë dhënien e pëlqimit të gjyqtarit {...} me komunikimin elektronik, datë 31.07. 2024, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 11.09.2024.
3. Gjyqtari {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatën ku ka caktimin e përhershëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
4. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimit ”arrest në burg” dhe “arrest në shtëpi” për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor.
5. Ngarkohet zv. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së Gjyqtarit {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykatë, duke marrë në

konsideratë ngarkesën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë dhe Durrës, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.

6. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
7. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**